



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .07.2023

**MBLEDHJA Nr. 36,**  
**Datë 10.07.2023, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 10.07.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 36 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 04.07.2023
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Qershor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
3. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjeshëm dhe modifikimin e pjeshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për Hec-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.
4. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr.40, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”, i ndryshuar

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**